



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 293/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Rahovec, për shkak të kërcënimit dhe shantazheve në forma të ndryshme nga ana e punëtorëve të KEK-ut si dhe nga ana e anëtarëve të KVV-së nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2010, mori këtë:

### V E N D I M

Hidhet poshtë ankesa si e pasafatshme

### A R S Y E T I M I

Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Rahovec, gjegjësisht komisionari i këtij subjekti politik z.Halit Krendali, ka paraqitur vazhdimisht vërejte të menaxheri i QV-së me pretendim se në Qendrën e Votimit (QV) nr.1620a/01D në fshatin Hoq e Madhe komuna e Rahovecit, për prezencën e punëtorëve të KEK-ut në korridor dhe në hyrje te QV-së, të cilët kanë shantazhuar dhe kërcënuar votuesit në forma të ndryshme që të votojnë për kandidatin e AAK-së.

### F A K T E T

Më 23 Nëntor 2010, në ora 18:00, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një ankesë nga Subjektit politik PDK dega në Rahovec, me pretendim se punëtorët e KEK-ut, kanë shantazhuar dhe kërcënuar votuesit në forma të ndryshme që të votojnë për kandidatin e AAK-së, e ku si rezultat i mospërfilljes së vërejtjes nga ana e komisionarit, në fund të procesit të votimit komisionari nuk e ka nënshkruar FRP. Poashtu sipas parashtresës të ankesës në QV 1620a/01D, ka pas manipulim të votave duke u nënshkruar në LPV dhe duke futur fletëvotime të plotësuara nga ana e anëtarëve të KVV-së te subjektit politik AAK-së .

## ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* Ligji Nr. 03/L- 072.

*Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së*

*Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes një ankesë pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetëdy (72) orëve nga koha kur është parashtruar ankesa.*

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme, sepse ankesa në PZAP është pranuar pas shtatëdhjetënjë (71) orëve, të mbylljes së Qendrës së Votimit ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa  
A nr. 293/2010 më datën 24.11.2010.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**

